

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me zyrtarin ligjor Shaban Prekalla, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit J.H., nga Ferizaj, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.3 nën par.3.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësueses së palës së dëmtuar H.H., av.Z.Z., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.929/18, të dt.28.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 26.02.2019, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e përfaqësueses të palës së dëmtuar H.H., av.Z.Z., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.929/18, të dt.28.09.2018, **vërtetohet**.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.929/18, të dt.28.09.2018, është shpallur fajtor i akuzuari J.H., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.3 nën par.3.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3(tre)muaj, i cili dënim në kuptim të nenit 47 të KPK, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 250(dyqindepesëdhjetë)Euro, të cilin dënim është obliguar i akuzuari që të paguaj në afat prej 60ditësh, kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, atëherë i njëjti në kuptim të nenit 46 par.3 të KPK, do të shndërrohet në dënim me burgim, duke llogaritur nga 20Euro, për çdo ditë të kaluar në burg.

E dëmtuara H.H., nga Ferizaj, për realizmin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civilo - juridik.

Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës dhe të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 Euro, në afatin prej 60 ditëve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Gjithashtu obligohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30Eurove, brenda afati prej 60 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesja e palës së dëmtuar H.H., av.Z.Z., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa e ushtruar të aprovohet, aktgjykimi i ankimuar ta anulohet në tërësi apo pjesërisht dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendim ose i njëjti të ndryshohet, në drejtim të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i ashpër.

Përgjigje në ankesën e përfaqësueses së palës së dëmtuar H.H., av.Z.Z., ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit J.H., av.F.SH., duke propozuar që të refuzohet ankesa e përfaqësueses së palës së dëmtuar si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.130/2019, të datës 12.02.2019, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e përfaqësueses së palës së dëmtuar H.H., av.Z.Z., ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i ashpër.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

#### **Ankesa e përfaqësueses së palës së dëmtuar H.H., av.Z.Z., nuk është e bazuar.**

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit për sanksionin penal, duke theksuar se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe se gjykata e shkallës së parë, nuk ka aplikuar drejt dispozitat ligjore nga neni 46 par.3 të KPK, kur ka vendosur që dënimi me burgim ti zëvendësohet me dënimin me gjobë, sepse nuk e ka paraparë në mënyrë taksative sa ditë duhet të kaloj në burg i akuzuari dhe se me rastin e aplikimit të kësaj dispozite ligjore ka ra në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 74 par.2 të KPK, sepse nuk i ka vlerësuar shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarit në veprën penale, shkallën e dashjes, prezencën permanente të dhunës dhe kanosjes, brutalitetin e përsëritur me vite ndaj viktimës, ashtu që me dënimin e shqiptuar jemi të mendimit se nuk mund të arrihet efekti dhe qëllimi i dënitimit, i paraparë në dispozitën përkatëse ligjore.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana

e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën e kryer penale, sipas dispozitave përkatëse ligjore, se është penduar për veprën e kryer penale, se ka kërkuar falje nga e dëmtuara, se ka premtuar që nuk do të përsërisë më veprime të tilla kundër të dëmtuarës pasi me të njëjtën nuk jeton, se ka pasur sjellje korrekte në shqyrtimin fillestar, kurse sa i përket rrethanave rëndues në këtë çështje penale nuk ka gjetur, sikurse nuk ka gjetur asnjë nga rrethana rënduese në ankesën e përfaqësueses së palës së dëmtuar, andaj, në prani të këtyre rrethanave kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1. nr.109/19 të datës 26.02.2019**

**Zyrtari ligjor**  
**Shaban Prekalla**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Biljana Rexhiq**